

**William R. Hite, Jr., Ed.D.**  
Superintendent


27 Janar, 2021

Pas gati një viti 100% mësimi dixhital për shkak të COVID-19, Drejtoria Arsimore do të fillojë ngadalë dhe në mënyrë të sigurt fazat në grupe të studentëve që zgjedhin të kalojnë në një përzjerje të të mësuarit në - person dhe dixhital. Studentët që vendosin të mësojnë hibrid do të ndjekin shkollën në - person dy ditë në javë - vetëm në ditët e tyre të caktuara - dhe do të merren me mësimin dixhital tre ditët e mbetura.

**Familjet e studentëve Pre/k-2 të cilët zgjedhën mësimin hibrid gjatë procesit fillestar të përzgjedhjes në vjeshtë do të fillojnë fazën e parë, të Hënën, 22 Shkurt.** Personeli mbështetës për nxënësit Pre/k-2 do të kthehen në ndërtesat e shkollave të Hënën, 8 Shkurt për të mirëpritur studentët më 22 Shkurt. Familjet Pre/K-2 të cilat zgjedhën të qëndrojnë 100% dixhitalë gjatë procesit të përzgjedhjes do të kenë mundësinë të zgjedhin në një datë të mëvonshme. Drejtuesit e shkollës do t'ju drejtohen familjeve Pre/K-2 me detaje specifike. Ndërsa fillojmë të kalojmë në të mësuarit në - person, ne e bëjmë këtë me besimin e ditur se ne jemi duke u përgatitur që nga Pranvera 2020. Çdo shkollë ka marrë masa të gjera të sigurisë për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqënien e studentëve dhe personelit tonë, duke përfshirë: kërkesat e para-shqyrtimit për studentët dhe personelin,

- pajisjet personale mbrojtëse (PPE) për personelin dhe studentët për të mbështetur veshjen e detyrueshme të maskës dhe mbulimin e fytyrës,
- klasa të reja dhe rregullimet e banjës për të promovuar distancën sociale,
- ndarjet e pleksiglasit në zyra,
- stacionet sanitare të pastrimit të duarve dhe stacione hidratimi në korridore,
- shënja maksimale jashtë çdo klase dhe sinjalistikë sigurie ,
- protokolle të pastrimit duke përdorur produkte pastrimi të aprovuara nga EPA. Vlerësimet e ventilimit gjithashtu kanë përfunduar për të gjitha shkollat, dhe riparimet / ose përmirësimet e nevojshme janë duke u zhvilluar. Çdo klasë për të cilën nuk mund të sigurohemi se do të përmbushë standartet e ventilimit nuk do të përdoret. Unë ju inkurajoj të vizitoni [www.philasd.org/aes](http://www.philasd.org/aes) për të gjetur video të dobishme, protokolle sigurie, pyetje dhe përgjigje, burime të tjera në lidhje me raportet e ventilimit të shkollës. Të mësuarit në person mund të bëhet në mënyrë të sigurtë nëse të gjithë bëjmë pjesën tonë, mbetemi të durueshëm, fleksibël dhe planifikojmë përpara. Ne do të vazhdojmë të ndajmë azhurnime ndërsa i afrohemi ngadalë dhe në mënyrë të sigurtë fazave për të mësuar në - person.

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.  
Superintendent  
Drejtoria Arsimore e Filadelfias